



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 74/2012
Prishtinë, më 14.09.2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri., Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi – ZPRK; Dita Dobranja – INDEP dhe Flamur Hyseni-NDI .

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 04.09.2012;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 04.09.2012

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 04 .09.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e konsumatorit

Kryetari – Tha se për këtë Projektligj grupi i punës ka nxjerrë disa propozim-amendamente, dhe ne i kemi miratuar në mbledhjen e fundit, por ende kanë mbetur për shqyrtim disa çështje që kanë të bëjnë me dispozitat ndëshkuese. Më pas, fjalën ia dha kryesuesit të grupit të punës, z. Hashim Deshishkut.

Hashim Deshishku – Tha se grupi i punës ka mbajtur disa takime, ku është shqyrtuar Projektligji Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit, deri te kreu XIX, te dispozita ndëshkuese ose neni 73, ku kemi edhe një propozim nga deputetja Biserka Kostiq. Pastaj kemi propozime nga ministria, ku me kërkesën tonë i ka sjellë disa propozime për ulje të gjobave dhe një propozim të INDEP-it për shtimin e disa neneve të reja. Ai njoftoi se së bashku me kryetarin e Komisionit ka pasur një takim me ministren Mimoza Kusari – Lila, në lidhje me këto paqartësi.

Biserka Kostiq – Tha se qëndron prapa propozimet të saj në mbledhjen e Komisionit, ku ka prezantuar amendamentin që në nenin 73 të shtohet një paragraf më gjobë për ata që nuk e zbatojnë nenin 4.

Myzejene Selmani – Tha se do të duhej të marrim praktikën e vendeve të tjera më të zhvilluara dhe të mos dalim të ndarë me mendime si Komisioni, por të marrim modelin më të mirë dhe t'i rregullojmë këtë çështje.

Lutfi Zharku – Tha se në bazë të përvojës time si ministër nuk kemi pasur kurrë pengesa për gjuhet e huaja, apo ato që fliten në Kosovë, por zakonisht kemi pasur përvojë të keqe që nuk është zbatuar ligji për gjuhen shqipe. Ai shfaqti shqetësimin e biznesit, sepse po ngarkohen më këso barriera në të ardhmen. Dhe, dha idenë që të marrim mendimin nga zyra ligjore në lidhje me këtë çështje.

Visar Ymeri – Tha se krejt ajo çka po kërkohet nga deputetja Kostiq është në nenin 4 dhe ne e kemi pranuar amendamentin 11. Por me propozimin tjetër ajo vetëm po e sforcon më shumë nenin 4. Ai tha se e tëra çka po kërkohet është edhe në nenin 5 dhe neni 73 e sanksionon nenin 5 nëse ai nuk zbatohet dhe parashihet dënimi.

Teuta Sahatqija – Tha se me propozimin e deputetes Kostiq vetëm po dublifikojmë norma të panevojshme, sepse gjithçka është e qartë të neni 4 dhe i sanksionuar me nenin 73.

Biserka Kostiq – Ajo përsëriti propozimin e saj dhe tha se duke u bazuar në Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin në fuqi, neni 73, pas paragrafit 1 t'i shtohet një paragraf i ri 1.1 si vijon: “Nëse nuk zbatohet dispozitat e neni 4 të këtij ligji”. Deputetja tha se nëse Komisioni nuk e përkrah këtë amendament, ajo njoftoi se do të kërkojë që të votohet në seancë plenare dhe ka përkrahjen e partisë së saj dhe koalicionit 6+.

Pas debatit më 4 (katër) vota Për; 3(tri) Abstenim dhe 2 (dy) Kundër; Komisioni e përkrahu Amendamentin e deputetes Kostiq.

Komisioni, po ashtu, përkrahu edhe propozimin e INDEP dhe propozimet e MTI-së.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

- 1. Miratohen amendamentet për Projektligjin Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit.*
- 2. Raporti me amendamente i dërgohet komisioneve të përhershme sipas procedurës së rregullt.*

4. Të ndryshme

Çështje vijuese;

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit